



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1 paragrafi 1.7 pika (a), (b) dhe (c) të Rregullores nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke pasur parasysh nenin 12 të Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.

Me qëllim të përkrahjes së familjeve dhe individëve me nevoja të jashtëzakonshme në rastet emergjente, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 06/2005 PËR RREGULLIMIN E
PROCEDURAVE TË PËRKRAHJES FINANCIARE FAMILJEVE DHE
INDIVIDËVE NË RASTE TË JASHTËZAKONSHME**

Neni 1

Qëllimi i nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ

1.1 Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohen dhe përcaktohen procedurat e përkrahjes financiare nga MPMS-ja për nevoja të jashtëzakonshme të familjeve dhe individëve nevojtare në Kosovë.

Neni 2

Definimi i termit “nevojat e jashtëzakonshme”

2.1 Kuptimi i termit “nevojat e jashtëzakonshme” sipas dispozitave të Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale, në funksion të zbatimit të këtij Udhëzimi Administrativ, definohet si nevojë momentale, e njëhershme, e jashtëzakonshme dhe jo e vazhdueshme, e cila ju sigurohet familjeve dhe individëve për shpenzimet e varrimit të anëtarit të familjes, për strehim apo ushqim me rastin e vërshimeve apo tërmetit, për sigurimin e lëndëve djegësve për ngrohje, për humbje të dokumentacionit me paratë e fundit, dhe nevoja të tjera të jashtëzakonshme të cilat janë të domosdoshme me rastin e fatkeqësive të ndryshme.

Neni 3

Proceduarat për përkrahjen e nevojave të jashtëzakonshme

- 3.1** Kërkesa për përkrahje financiare lidhur me nevojat e jashtëzakonshme nga familja apo individi, dorëzohet në Qendrën për Punë Sociale, në territorin e secilës gjendet vendbanimi i parashtruesit të kërkesës, apo ku ka ndodhur rasti.
- 3.2** Së bashku me kërkesën parashtruesi i kërkesës, duhet të dorëzojë edhe dokumentacionin e vërtetuar nga organi zyrtar përmes të cilit konfirmohet rasti i ndodhur i cili do të shërbejë si kriter për mbështetje financiare për nevoja të jashtëzakonshme, (certifikata e vdekjes së anëtarit të familjes lëshuar nga mjeku kompetent, vërtetimit nga Bashkia për shkatërrimin apo dëmtimin e pasurisë, procesi i policisë për paraqitjen e humbjes së dokumenteve së bashku me paratë, etj.)
- 3.3** Kërkesën për plotësimin e nevojave të jashtëzakonshme në afat prej tri (3) ditësh nga dorëzimi në QPS e shqyrton komisioni vlerësues i DMS-së të MPMS-së.
- 3.4** Anëtarët e komisionit vlerësues i propozon Drejtori i DMS-së në konsultim me Sekretarin e Përhershëm të MPMS-së.
- 3.5** Mandati i anëtarëve të komisionit vlerësues zgjat dy (2) vite, me mundësi vazhdimi edhe për dy (2) vite të tjera.
- 3.6** Pas aprovimit të propozimit nga ana e drejtorit të DMS-së të MPMS-së, kërkesa me vendimin e komisionit vlerësues dërgohet në Departamentin e Administratës Qendrore të MPMS-së në procedurat e mëtejshme të realizimit.

Neni 4

Administrimi dhe financimi i skemës së nevojave të jashtëzakonshme

- 4.1** Sipas Ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, skema e nevojave të veçanta të jashtëzakonshme administrohet nga MPMS-ja përmes Qendrave për Punë Sociale.
- 4.2** Nevojat e veçanta të familjeve dhe individëve do të përmbushen nga buxheti i dedikuar për këtë skemë i cili më së shumti mund të jetë 500.000 €(euro) për një vit.
- 4.3** Rritja eventuale e këtij buxheti mund të bëhet përmes marrëveshjes paraprake me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.
- 4.4** Për momentin aktual mjetet buxhetore për këtë skemë janë koncentruar në nivel të MPMS-së, ndërsa me krijimin e mundësive të shpërndarjes së mjeteve buxhetore në proporcion me numrin e popullatës të cilin e mbulon QPS-ja, mjetet buxhetore do të shpërndahen në nivelin e QPS-ve.

Neni 5

Kushtet dhe kriteret për përfitim nga skema e nevojave të jashtëzakonshme

- 5.1** Të drejtë aplikimi në skemën e nevojave të jashtëzakonshme kanë të gjitha familjet dhe individët, të cilët aplikojnë në përputhje me nenin 12 të Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, nenin 17 të Rregullores zbatuese të këtij Ligji, dhe me nenin 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.
- 5.2** Me rastin e aplikimit në skemën për nevoja të jashtëzakonshme, parashtruesi i kërkesës, së bashku me kërkesën duhet të dorëzojë dhe dokumentacionin – provat e tjera materiale siç janë përcaktuar me nenin 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.
- 5.3** Familja apo individ i mund të aplikojnë për skemën e nevojave të veçanta, pavarësisht se janë, apo nuk janë shfrytëzues të ndihmave sociale.
- 5.4** Parashtruesi i kërkesës mund të aplikojë për nevoja të veçanta të njëjta, vetëm në një QPS të MPMS-së.
- 5.5** Parashtruesi i kërkesës për përkrahje të nevojave të jashtëzakonshme, gjatë vitit mund të aplikojë vetëm një herë. Në rast se aplikon dy herë apo më shumë brenda vitit, atëherë do të mungojë përkrahja financiare e MPMS-së.
- 5.6** Familjet apo individët të cilët kanë të ardhura të përgjithshme familjare më të mëdha se 150 euro në çdo muaj, duke përfshirë edhe pagesat e skemave pensioanle dhe të ndihmave sociale nuk do të përfitojnë nga skema e nevojave të veçanta.

Neni 6

Lartësia e shumës për nevoja të jashtëzakonshme

- 6.1** Lartësia e pagesës për përkrahje financiare përkitazi me nevojat e jashtëzakonshme, mund të jetë deri në 100 euro më së shumti.
- 6.2** Në raste të jashtëzakonshme, të cilat janë shumë të dhimbshme dhe të rënda për familjen apo individin, lartësia e pagesës për nevoja të veçanta me vendim të Ministrit të MPMS-së, mund të ndryshohet duke u rritur deri në 300 euro më së shumti.
- 6.3** Lartësia e pagesës për nevoja të veçanta mund të ndryshojë nga viti në vit, varësisht nga mjetet buxhetore të destinuar për këtë qëllim për një vit.

Neni 7

Regjistrimi i parashtruesve të kërkesave për nevoja të jashtëzakonshme

- 7.1** Qendrat për Punë Sociale të MPMS-së duhet të mbajnë evidencë të saktë për të gjithë parashtruesit e kërkesës që aplikojnë për përkrahje financiare për shkak të nevojave të jashtëzakonshme.
- 7.2** Me rastin e pranimin të kërkesave nga aplikuesit për përkrahje financiare për nevoja të veçanta, QPS-së duhet të formojnë dosjen e kompletuar për secilin parashtrues të kërkesës.
- 7.3** Divizioni i ndihmave sociale të DMS-së në MPMS duhet të mbajë evidencë të veçantë për të gjithë përfituesit nga skema e ndihmave të jashtëzakonshme përkatësisht, për parashtruesit e kërkesës të cilët janë refuzuar nga komisioni vlerësues i MPMS-së.

Neni 8

Hyrja në fuqi

- 8.1** Ky udhëzim Administrativ hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të aplikohet në mënyrë retroaktive nga 01.01.2005.

Prishtinë, maj 2005

**Ministri i MPMS-së
Ibrahim Selmanaj**
